
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	<p>PRISHTINA</p> 
---	--	--

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 44 dhe 45 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Marrëveshjes për Partneritet Publiko Privat me nr.14-024/01-264908/22 dt.08.12.2022 dhe në bazë të kërkesës 05 Nr.350/02-271902/22 dt. 19.12.2022, e autoritetit kontraktues Komuna e Prishtinës me partner privat “Bao Schools”Sh.p.k., Rr.Raif Pollomi, p.n.Mati 1, Prishtinë për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për ndërtimin e ndërtesës shkollore në lagjen Sofalia, në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 07.03.2023, merr këtë:

V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I Caktohen kushtet ndërtimore kërkuarit/autoritetit kontraktues Komuna e Prishtinës me partner privat “Bao Schools”Sh.p.k, sipas kërkesës 05 Nr.350/02-271902/22 dt. 19.12.2022, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e ndërtesës shkollore, në kuadër të parcelës ndërtimore “E-08”, të tërësisë “E”, të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr.780-1, 780-2 dhe 779-0, ZK. Sofali.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të bllokut urban “E-08”, të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”, i miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr.031-247790 të dt. 04.10.2016, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “Hapësirë Publike”.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - nr. 780-1, ZK.Sofalia, me S=32,174m², me pronar Komuna e Prishtinës, kualiteti i tokës Arë e klasës 4;
 - nr. 780-2, ZK.Sofalia, me S=7,195m², me pronar Komuna e Prishtinës, kualiteti i tokës Arë e klasës 4;
 - nr. 779-0, ZK.Sofalia, me S=25,356m², me pronar Komuna e Prishtinës, kualiteti i tokës Arë e klasës 4;

Sipërfaqja totale e parcelave është S=64,725m²

- E drejta pronësore-juridike është publike/pronë Komunale, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatave të njësive kadastrale;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni është relativisht të pjerrët, me disnivel ~8-10m;
- Qasja ekzistuese e parcelës kadastrale është përmes rrugës ekzistuese / të planifikuar;
- Parcelat kadastrale nr.780-1, 780-2 dhe 779-0, ZK. Sofali, shtrihen në kuadër të parcelës ndërtimore “E-08”, të tërësisë “E”, të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”;

- Mbi një pjesë të parcelës kadastrale nr.780-1, 780-2 dhe 779-0, ZK. Sofali, kalon infrastruktura rrugore e planifikuar;
- Në kuadër të parcelave kadastrale 780-1 dhe 780-2, ZK.Sofali, është i ndërtuar një objekt kulti, një Xhami ndërsa në perimetrin prej 50m' të parcelave kadastrale në fjalë ka ndërsa banimi.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin - ndërtimin e ndërtesës shkollore, në kuadër të bllokut urban "E-08", të tërësisë "E", të Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia", bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Plani i lokacionit – "zgjidhja urbane", bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;

- Parcelat kadastrale të trajtuara për realizimin e ndërtesës shkollore -të trajtuara brenda vijës rregulluese, janë:

- nr. 780-1, ZK.Sofalia dhe 780-2, ZK.Sofalia , me $S=7,641m^2$;

- nr. 779-0, ZK.Sofalia, me $S=2,884m^2$;

Sipërfaqja totale e trajtuar brenda vijës së rregullimit është $S=10,525m^2$

- Parcelat kadastrale gjegjësisht pjesët e parcelave kadastrale të patrajtuara me këto kushte ndërtimore, jashta vijës rregulluese të bllokut E-08, janë:

- nr. 780-1, ZK.Sofalia dhe 780-2, ZK.Sofalia , me $S=31,728m^2$;

- nr. 779-0, ZK.Sofalia, me $S=22,472m^2$;

Sipërfaqja totale e pa trajtuar me këto kushte ndërtimore është $S=54,200m^2$

- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" është destinim publik konkretisht shkollë e mesme dhe në harmoni me këtë është e projektpropozimi;
- Organizimi, funksionet përcjellëse dhe ato primare në tërësi të jenë sipas detytrës projektuese dhe Udhëzuesit për Normat dhe Standardet e Ndërtesave Shkollore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës si dhe Udhëzuesit, UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave,
- Etazhiteti maksimal i lejuar, sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia", është P+2, kurse i propozuar dhe i miratuar është B+P+2;
- Sipërfaqja minimale e parcelës për shkollë fillore duhet ti plotësoj kriteret e sipërfaqes prej 25-50m²për nxënës, ndërsa bruto sipërfaqja e ndërtesës duhet të ketë min.5m²për nxënës;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore- brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdhësës ose suterren, sipas "Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia", është max.30%;
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore/parcelave kadastrale të bashkuara në kompleks (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdhësës ose suterrenit, lejohet max. 40%, dhe këto sipërfaqe janë si në vijim:

Ndërtesa shkollore – "Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia"

ISHP për katin përdhësë dhe suterren:

$S=10,525m^2 \times 0.3 = 3,157.50 m^2$ /sipas planit rregullues/;

$S= 1,340.50 m^2$ /sipas projekt propozimit/

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelave kadastrale për etazhet e nëntokës (ISHPN) për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të bodrumit, bazuar kriteret e "Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia", lejohet max.50%, dhe sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, kjo sipërfaqe është:

Ndërtesa shkollore – "Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia"

$S=10,525m^2 \times 0.5 = 5,262.50 m^2$ / sipas planit rregullues dhe vendimit/;

$S=1,984.0m^2$ /sipas projekt propozimit/.

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (ISGJ), bazuar në planin rregullues dhe në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është 0.5 (50%), dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim,

Faqe 2 prej 7

0.3 (30 %), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe kjo sipërfaqe është:

Ndërtesa shkollore – “Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”

$S=10,525m^2 \times 0.5 = 5,262.50 m^2$ / sipas planit rregullues/;

- Koefficienti i ndërtimit të etazheve të mbi tokës (ISPN) për parcelën ndërtimore “E-08” të tërësisë hapësinore “E”, është max. 0.6. Dhe numri i kateve është max.P+2. Trajtimi i sipërfaqes ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - *suteren*, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – *bodrum*, dhe kjo sipërfaqe është:

Ndërtesa shkollore – “Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”

$S=10,525m^2 \times 0.6 = 6,315.00 m^2$ /të lejuara sipas planit rregullues, brenda parcelës ndërtimore/;

$S=3,609.70m^2$ /mbi tokë / sipas projekt propozimit /.

- Distanca e vendosjes së ndërtesave ndaj kufirit të parcelës ,për kthina primare min. 0.5H, për kthina sekondare min.0.2H,dhe marrëveshja me fqin deri në bashkim të plotë,
- Kuota e përdhësës së ndërtesës përcaktohet në raport me kuotën e niveletës së rrugës publike nga e cila ka çasje parcela, gjegjësisht në krahasim me kuotën zero,
- Kuota e përdhësës së ndërtesave të reja nuk mund të jetë më e ulët se kuota e niveletës së rrugës publike,
- Ngritja e nivelit të përdhësës nga niveli i terrenit- trotuarit të ndërtesës, lejohet të jetë max.1.2 m;
- Distanca në mes vijës ndërtimore dhe asaj rregulluese është 5.0 m;
- Nëse në fasadat e ndërtesës me orientim nga fqinjët nuk ka hapje ndriçim distanca minimale është 0.2h nga kufiri i parcelës. Por me pëlqim paraprak te fqinjëve, kjo distance mund të zvogëlohet deri në bashkimin e plotë;
- Nëse parcela ka pjerrtësi tereni i tillë që mbulon më shumë sesa një kat në njërin drejtim, atëherë sipërfaqja ndërtimore llogaritet 50%.
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016, protokoluar me numrin 01nr.031-185481, për arsye të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e termoizolimit në fasadat e ndërtesës, nuk do të përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore (ISHN), e as në kalkulimin për taksën e lejes ndërtimore;
- Qasja në kompleks të jetë nga rruga e planifikuar edhe me Planin Rregullues “Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vendparkimet e jashtme, shtigjet, trotuaret, terrenet e hapura sportive, mobiluar urban, etj.;
- Të planifikohet 1 vendparkime/50nxënës.Parkingjet e jashtme të planifikohen në atë mënyrë që të mos zvogëloj kriterin prej 40% sipërfaqe gjelbërim të jashtë, sipas pikës IV, paragrafi 9, i këtyre Kushteve Ndërtimore;
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për grumbullimin dhe vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura - dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit dhe natyrës së ndërtesës;
- Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuara në kriteret dhe parametrat urban të “Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”.

VI. Ndarja/parcelimi i parcelave kadastrale nr.780-1, 780-2 dhe 779-0, ZK. Sofali, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore “E-08”, të përcaktuara me vijën rregulluese me rrugët e planifikuara të planit rregullues urban, si dhe bazuar në Plani i situacionit-“zgjdhja urbane”, vijës rregulluese të bllokut urban “E-08”, të tërësisë hapësinore “E”, dispozitës urbanistike punuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes dhe bashkimit, të punuar nga gjeodeti i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - “zgjdhja urbane” dhe “Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01”, punuar nga kjo drejtori dhe manuali i ndarjes dhe bashkimit, punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në

Faqe 3 prej 7

pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas vendimit të kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të aplikuesit duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - "zgjdhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes dhe bashkimit, punuar nga gjeometri i licencuar, e të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

V. VII. Bashkimi i pjesëve & parcelave kadastrale nr.780-1, 780-2 dhe 779-0, ZK. Sofali, në pronësi komunale, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore "E-08", të përcaktuar me vijën rregulluese me rrugët e planifikuara të planit rregullues urban, bazuar në Plani i situacionit – "zgjdhja urbane", si dhe Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga "Plani Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manuali i bashkimit punuar nga gjeometri i licencuar.

Andaj, drejtorja jep PËLQIM për bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjdhja urbane" & Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga "Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia", në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkim të punuar nga gjeometri i licencuar.

Procedura e bashkimit do të realizohet pas realizimit të procedurës në paragrafin VI të vendimit të kushteve ndërtimore dhe bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e cila do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operativ kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Bashkimi të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, me kërkesë të aplikuesit si dhe bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga "Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkim të punuar nga gjeometri i licencuar.

VIII. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

IX. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinore, Udhëzuesit për Normat dhe Standardet e Ndërtesave Shkollore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, "Udhëzimit Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara", normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - Planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;

- Situacionin - Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë, relative dhe absolute;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare;
- Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detaje e nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr.035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të zhvilluara në terren;

X. Dokumentacioni ndërtimor për Masat e mbrojtëse nga zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni ndërtimor për **Leje Mjedisore Komunale** të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;

XI. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarët dhe investitorin.

Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

XII. Paga e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcelat kadastrale nr.780-1, 780-2 dhe 779-0, ZK. Sofali, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, janë të evidentuara me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit “Arë e klasës 4, kërkohet që paraprakisht të bëhet paga e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Plani i situacionit-“zgjidhja urbane”-parcelës ndërtimore, dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej S=10,525m². Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrat kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Ky kompensim-pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore

XIII. Paga e taksës administrative për leje ndërtimi dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të kalkulohet/realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Paga e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XIV. Kusht i veçantë para aplikimit për leje ndërtimore të bëhet analiza e llojit të drunjëve ekzistues, dhe në varësi të asaj analize të shqyrtohet mundësia e ruajtjes së tyre.

XV. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor,si dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës me partner privat “Bao Schools”Sh.p.k, Prishtinë, me kërkesën 05 Nr.350/02-271902/22 dt. 19.12.2022, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për ndërtimin e ndërtesës shkollore, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, pronari ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim: Certifikatat e njësisë kadastrale dhe kopjet e Planit për parcelat kadastrale nr.780-1, 780-2 dhe 779-0, ZK. Sofali;Inçizimin gjeodezik dhe projektpropozimin e punuar nga kompania "Alko-H"N.Sh.Mati 1, Ndue Përlleshi, p.n.Prishtinë

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës 05 Nr.350/02-271902/22 dt. 19.12.2022, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni-Planin Rregullues të Hollësishëm "Sofalia", rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative dhe projektit konceptual, duke u bazuar në nenin 18 të Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, pikën 1.2 dhe 1.2.2 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, kjo drejtori me datë 09.02.2023, ka vendosur njoftimin publik në hapësira të dukshme dhe frekuentuese të lokacionit dhe rrethinës në diametër prej 50 m', për të njoftuar publikun me synimet e aplikuesit dhe i njëjti është lënë në dispozicion të tyre, për t'ju mundësuar të interesuarve paraqitjen e vërejtjeve dhe komenteve. Ky njoftim publik ka qëndruar 15 ditë, deri me datën 23.02.2023, dhe gjatë kësaj periudhe kohore, në postën elektronike zyrtare nuk ka arritur asnjë ankesë, kërkesë, vërejtje apo sugjerim nga qytetarët e asaj zone.

Bazuar në konstatimet e më sipërme dhe dokumentacionin e shqyrtuar, plotësim dokumentacionit të dorëzuar me dt.07.03.2023 si dhe bazuar në Marrëveshjen për Partneritet Publiko Privat me nr.14-024/01-264908/22 dt.08.12.2022 lidhur ndërmjet Komunës së Prishtinës si autoritet Kontraktues dhe Bao Schools, Sh.p.k. si partner privat, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, nenin 13 të "Udhëzim Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit-"zgjidhja urbane", është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Dispozita urbanistike -"zgjidhja urbane" me ndërtesë të planifikuara; Situacioni i parcelave kadastrale me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01; Manuali gjeodezik i ndarjes dhe bashkimit të parcelave kadastrale me nr.780-1, 780-2 dhe 779-0, ZK. Sofali.

Udhëzimi juridik:Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror-MMPHI.

Ky vendim u printua në 5 (pesë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05 Nr.350/02-271902/22 dt. 19.12.2022.


Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Inspektionit, Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-271902/22 DT. 07.03.2023**

Zyrtari,
Anita Osmani



Udhëheqëse e Sektorit
Nazife Krasniqi



DREJTORI,
Arber Sadiki



Faqe 7 prej 7



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinar /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice: 00779-2, 00780-4


Zona kadastrale / Katastarska zona: Sofali

Numri i lëndës / Broj predmeta: _____

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 750

Nr	Y	X	H	Kodi	Përshkrimi	Burimi
1	7515708.810	4725216.876	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
2	7515735.138	4725215.930	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
3	7515744.323	4725212.593	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
4	7515752.299	4725211.177	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
5	7515760.087	4725208.156	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
6	7515767.644	4725206.452	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
7	7515774.975	4725203.088	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
8	7515781.055	4725199.033	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
9	7515787.526	4725196.076	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
10	7515788.644	4725193.037	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
11	7515788.887	4725194.588	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
12	7515789.054	4725194.302	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
13	7515789.139	4725193.601	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
14	7515789.148	4725191.070	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
15	7515789.058	4725192.585	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
16	7515788.893	4725192.301	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
17	7515788.652	4725191.651	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
18	7515788.339	4725191.246	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
19	7515787.965	4725190.878	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
20	7515787.539	4725190.614	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
21	7515782.933	4725188.071	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
22	7515782.269	4725186.274	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
23	7515777.911	4725184.073	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
24	7515775.927	4725181.539	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
25	7515774.336	4725178.731	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
26	7515773.189	4725176.715	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
27	7515772.522	4725173.563	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
28	7515772.262	4725169.705	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
29	7515771.532	4725167.367	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
30	7515773.142	4725163.882	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
31	7515774.483	4725158.178	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
32	7515770.541	4725151.011	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
33	7515783.654	4725142.174	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
34	7515788.430	4725138.438	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
35	7515783.983	4725117.648	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
36	7515795.818	4725113.258	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
37	7515795.974	4725111.124	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
38	7515795.201	4725109.677	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
39	7515793.799	4725108.674	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
40	7515791.070	4725178.458	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
41	7515796.951	4725116.343	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
42	7515783.972	4725117.257	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
43	7515796.654	4725117.670	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
44	7515751.112	4725117.234	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
45	7515746.113	4725116.227	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
46	7515741.118	4725114.478	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
47	7515734.223	4725109.889	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
48	7515736.291	4725107.118	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
49	7515721.625	4725108.459	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
50	7515737.645	4725098.130	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
51	7515714.138	4725094.162	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
52	7515702.099	4725066.602	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
53	7515699.883	4725062.847	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
54	7515697.218	4725058.495	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
55	7515694.081	4725054.569	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
56	7515690.554	4725054.134	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
57	7515688.388	4725053.236	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
58	7515686.402	4725057.849	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
59	7515684.937	4725060.920	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
60	7515682.816	4725065.389	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
61	7515680.634	4725069.989	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
62	7515678.941	4725074.736	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
63	7515677.606	4725079.590	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
64	7515676.613	4725084.525	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
65	7515675.970	4725089.518	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
66	7515675.779	4725092.020	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
67	7515675.728	4725099.320	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
68	7515676.078	4725108.942	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
69	7515676.723	4725108.493	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
70	7515677.654	4725112.994	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
71	7515678.878	4725117.436	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
72	7515691.638	4725159.052	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
73	7515697.512	4725177.585	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
74	7515701.597	4725190.536	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
75	7515705.682	4725203.466	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM
76	7515707.928	4725212.852	0.000	2	Kurjë - shpyllë metalik	PM



- Legjenda
- Gjendja e shtetit
 - Gjendja e re
 - Pikat e shtetit
 - Pikat e reja
 - A Nr. i pikës së shtetit
 - A Nr. i pikës së re

Rilevimi / Snimio: Astrit Hajra
Prishtinë (emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ime i prezime gjeodeta/ kompanije)
Nr. i licencës / Br. licence: 232
Nënshkrimi / Potpis: _____
Data e rilevimit / Datum snimanya: 22.02.2023

Aprovimi / Usvojio: _____
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ime i prezime shërbëtorit/lica)
Nënshkrimi / Potpis: _____
Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____

V.V.

Date	Description	Amount
1912	Jan 1	100.00
1912	Feb 1	150.00
1912	Mar 1	200.00
1912	Apr 1	250.00
1912	May 1	300.00
1912	Jun 1	350.00
1912	Jul 1	400.00
1912	Aug 1	450.00
1912	Sep 1	500.00
1912	Oct 1	550.00
1912	Nov 1	600.00
1912	Dec 1	650.00
1913	Jan 1	700.00
1913	Feb 1	750.00
1913	Mar 1	800.00
1913	Apr 1	850.00
1913	May 1	900.00
1913	Jun 1	950.00
1913	Jul 1	1000.00
1913	Aug 1	1050.00
1913	Sep 1	1100.00
1913	Oct 1	1150.00
1913	Nov 1	1200.00
1913	Dec 1	1250.00
1914	Jan 1	1300.00
1914	Feb 1	1350.00
1914	Mar 1	1400.00
1914	Apr 1	1450.00
1914	May 1	1500.00

+

2



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 00779-0, 00780-0


Zona kadastrale / Katastarska zona: Sofali

Numri i lëndës / Broj predmeta: _____

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcelë

Shkalla e zvogëlimit / Razmera plana : 1 : 750

Nr	Y	I	X	H	Kod	Përshkrimi	Renditje	
574	7515708	0007	4725218	8767	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
575	7515705	1329	4725215	8995	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
576	7515744	8236	4725212	9057	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
577	7515782	2060	4725211	1308	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
578	7515708	0077	4725208	1568	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
579	7515707	0050	4725206	8236	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
580	7515705	0751	4725203	0828	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
581	7515782	0546	4725199	8177	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
582	7515787	5457	4725196	0646	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
583	7515788	6436	4725195	0377	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
584	7515788	8877	4725194	1878	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
585	7515788	0547	4725194	3047	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
586	7515788	1797	4725193	6067	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
587	7515788	1837	4725193	8095	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
588	7515788	0526	4725192	9481	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
589	7515788	0912	4725192	9041	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
590	7515788	0517	4725191	4508	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
591	7515788	3794	4725191	2497	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
592	7515787	8662	4725186	8878	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
593	7515787	3388	4725186	6161	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
594	7515782	8148	4725188	0801	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
595	7515780	2088	4725186	7742	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
596	7515777	9184	4725184	0711	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
597	7515775	9545	4725181	5393	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
598	7515774	1808	4725178	7314	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
599	7515773	1889	4725175	7146	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
600	7515772	5318	4725172	5597	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
601	7515772	3441	4725168	2046	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
602	7515772	5127	4725167	3666	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
603	7515773	1412	4725163	8813	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
604	7515778	6817	4725158	1777	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
605	7515776	5438	4725153	0997	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
606	7515778	6558	4725142	1798	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
607	7515788	4288	4725126	4382	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
608	7515785	0791	4725117	7567	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
609	7515785	1177	4725117	1679	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
610	7515785	0980	4725111	1212	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
611	7515785	3081	4725109	4388	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
612	7515785	7965	4725108	4743	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
613	7515782	0466	4725108	4177	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
614	7515786	9548	4725116	8428	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
615	7515784	0791	4725117	7567	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
616	7515786	6838	4725117	1687	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
617	7515784	3787	4725117	1841	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
618	7515746	1128	4725116	1265	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
619	7515742	1188	4725114	4780	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
620	7515738	2117	4725109	8897	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
621	7515738	2542	4725107	1178	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
622	7515728	6549	4725103	4528	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
623	7515717	6842	4725079	1198	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
624	7515754	1378	4725084	1624	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
625	7515729	0911	4725046	6646	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
626	7515688	0834	4725062	8477	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
627	7515687	2137	4725059	8948	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
628	7515684	0808	4725056	6692	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
629	7515684	5542	4725054	1187	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
630	7515688	2887	4725029	2168	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
631	7515686	0408	4725027	8488	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
632	7515688	9346	4725026	8027	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
633	7515682	6382	4725026	3684	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
634	7515688	6143	4725026	3883	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
635	7515678	0414	4725024	7361	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
636	7515677	6655	4725029	5888	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
637	7515676	6117	4725024	5351	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
638	7515676	9488	4725018	5178	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
639	7515676	7798	4725012	8888	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
640	7515676	7284	4725009	7187	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
641	7515676	0781	4725007	8436	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
642	7515676	7288	4725006	4931	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
643	7515677	6837	4725112	8940	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
644	7515678	8727	4725117	4280	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
645	7515696	6298	4725119	1621	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
646	7515687	5117	4725127	3858	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
647	7515701	3877	4725128	1268	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
648	7515729	0836	4725128	1842	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI
649	7515729	9779	4725121	8521	0000	2	Kamqë - s'hyjë në matje të	PAI



Legjenda

	Gjendja e vjetër
	Gjendja e re
	Pikë e vjete
	Pikë e reja
	A Nr i pikës së vjetër
	A Nr i pikës së re

Rilevori / Snimio: Astrit Hajra
Prishtinë (emri dhe mbiemri i geodet/kompanisë/ ime i prezime geodet/ kompanije)

Aprovi / Usvojio: _____
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime shërbëtorog lica)

Nr. i licencës / Br. licence: 232

Nënshkrimi / Potpis: _____

Nënshkrimi / Potpis: _____

V.V

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____



Data e rilevimit / Datum snimanja: 20.02.2023

Handwritten text at the top left corner, possibly a date or page number.

A large table with multiple columns and rows, containing faint text and possibly data. The table structure is not clearly legible due to the low resolution of the scan.



SIPËRFAQJA E PARCELËS - 9,297.368 m²
 SIPËRFAQJA E SHPËTËS SË OBJEKTIT - 2990.60 m²



Projekti Konceptual

Objekti Shkollor
 Socialia
 Sotat, Pishina, Korovë

Porositësi
BAO SCHOOLS
 P.R.A
 Nispete

Projektuesi



Beed Beedhë - Obj. 'A' 1. lok. 1
 Pishinë


Projektori:

RAIF BEKTESHI IDA

SOFALIA

ARKITEKTURA

Koncepti:



SITUACIONI

Niveli:

Skala:

Formati:

1 : 500

A 3

P 01